

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 3661 Prot.

Tiranë, më 10.04, 2017

UDHËZIM

Nr. M, datë 10.04 2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 03.12.2015 "PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT
TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 76 dhe pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë,

Udhëzoj:

1. Tabela nr. 1, bashkëlidhur udhëzimit nr. 52, datë 03.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Tabela 1/1

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njeh testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
Gjuha angleze			
Cambridge	PET	FCE	CAE
IELTS	4.0 / 5.0	5.5 / 6.0	6.5 / 7.0
TOEFL Internet-based Test (iBT)	57/86	87/109	110/120
TOEFL Paper-based Test (ITP)	460	543	627
TOEIC	381 / 649	650/ 785	786 / 935
GESE	-	7, 8, 9	10, 11
APTIS	Aptis B1	Aptis B2	Aptis C
Gjuha gjermane			
Goethe-Institut, Goethe Zentrum	Goethe-Zertifikat B1	Goethe-Zertifikat B2	Goethe-Zertifikat C1
TestDaF	-	TDN 3 - TDN4	TDN 5
Gjuha franceze			
TFI	345/604	605/824	825
DELFB	DELF B1	DELF B2	DALFC1
TCF	TCF 300 - 399	TCF 400 - 499	TCF 500 - 599
TEF	TEF 361-540	TEF 541-698	TEF 699-833
Gjuha italiane			
Peruggia	CELI2 livello2	CELI3 livello3	CELI4 livello4
Sienna	CILS uno B1	CILS 2	CILS 3
Gjuha spanjolle			
DELE	DELE inicial	DELE intermedio	DELE superior